



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Nr. 276 prot.

Tiranë, më 21.03.2020

Urdhër

Nr. 13 datë 31.03.2020

Për disa ndërhyrje urgjente
në depon e Akademisë së Shkencave në Lundër

Nisur nga gjendja shqetësuese e kushteve të ruajtjes së botimeve të Akademisë së Shkencave dhe të mallrave të tjerë në depon e Lundrës, siç është raportuar nga z. Florian Bodinaku dhe siç u konstatua gjatë verifikimit në vend më 4 mars 2020, të bëhet preventivi e të zbatohen menjëherë masat e mëposhtme:

1. Vendosja e xhamave në gjithë hapësirën e depos;
2. Instalimi i ndriçimit të brendshëm;
3. Sistemimi i fondit të botimeve dhe i fondit të bibliotekës në masën që e lejojnë kushtet e depos.
4. Ngarkohen sektori i botimeve dhe i bibliotekës, si dhe sektori i financës, për zbatimin e këtij urdhri.
5. Sekretari shkencor të negociojë me Ministrinë e Mbrojtjes, gjegjësisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, për kalimin në inventar të një hapësire në vijim të depos, me qëllim që të mundësohet inventarizimi dhe sistemimi i plotë i fondit në ruajtje në këtë depo.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

